

PERSPEKTIVAT PËR
TË ARDHMEN

**Seminar rajonal i zyrtarëve publikë në
Evropën dhe Azinë Qendrore**

**RAPORTIMI FINANCIAR PËR
TRANSPARENCËN E
BORXHIT DHE TË INVESTIMEVE**

1 dhjetor 2020

Seminar rajonal i zyrtarëve publikë në Evropën dhe Azinë
Qendrore

RAPORTIMI FINANCIAR PËR TRANSPARENCËN E BORXHIT DHE TË INVESTIMEVE

1 dhjetor 2020, 8:00 - 10:30 (me orën e Uashingtonit)

Pas shpërthimit të COVID-19, ekonomitë në zhvillim kanë pësuar flukse dalëse të konsiderueshme kapitalesh, ndërkohë që përballen me nivele historikisht të larta të borxhit, çka ua bën edhe më të vështirë këtyre vendeve rimarrjen e vetes nga situata ekonomike e rënduar nga pandemia. Për ta lehtësuar situatën, shumë vendeve po u vihet në dispozicion borxh me kushte lehtësuese në një shkallë të paprecedentë, për t'iu përgjigjur nevojave të qytetarëve gjatë krizës, përfshirë edhe në kuadër të nismës për pezullim të shërbimit të borxhit (NPSHB), e cila u është vënë në dispozicion vendeve të kualifikuara nëpërmjet Planit të Veprimit të Grupit G20.

Transparenca e detyrimeve financiare dhe e investimeve të qeverive është një hap kyç në menaxhimin e borxhit publik, në krijimin e një klime tërheqëse për investimet dhe në kthimin pas të prirjes për flukse dalëse të kapitalit.

Ky seminar konsultues i nivelit të lartë do të mbështetet në rezultatet e anketës rajonale për transparencën mbi borxhin dhe investimet dhe në njohuritë teknike globale të Bankës Botërore, për të analizuar sfidat dhe mundësitë kryesore për përmirësimin e proceseve dhe praktikave të raportimit dhe transparencës së borxhit dhe investimeve ndër qeveritë e Evropës dhe Azisë Qendrore.

Ky seminar do të zhvillohet me pjesëmarrjen e zyrtarëve shtetërorë, të ekspertëve të Bankës Botërore dhe të përfaqësuesve të organizatave të tjera ndërkombëtare dhe do të dalë me masa/rekomandime konkrete, që mund të realizohen nga qeveritë dhe nga institucionet financiare ndërkombëtare.

PROGRAMI | 1 DHJETOR 2020, 8:00 - 10:30 (ME ORËN E UASHINGTONIT)

Drejtues i seminarit: **Dmitri Gourfinkel**, Specialist i lartë për menaxhimin financiar, Drejtues Ekipi për KPRF PULSAR, Banka Botërore

Mirëseardhja dhe hyrja

08:00

Lalita Moorty | Drejtoreshë për EFI në EAQ, prezantuar nga
Daniel Boyce | Menaxher, Praktika Globale Lindore për Qeverisjen, EAQ, BB

Prirjet globale në transparencën e borxhit

08:10

Doerte Doemeland | MP, Sektori për Makroekonominë dhe Borxhit MTI, Banka Botërore

Prezantim i gjetjeve dhe masave të propozuara të anketës

08:25

Svetlana Klimenko | Krye-Specialiste për Menaxhimin Financiar, Banka Botërore

Diskutim në tryezë të rumbullakët mes përfaqësuesve të qeverive dhe ekspertëve të fushës - Prezantime të vendeve mbi regjistrimin, raportimin dhe transparencën e borxhit dhe të investimeve

08:35

Prezantime nga Armenia, Republika e Kirgizstanit dhe Shqipëria.

Folës në panel:

Dritan Fino | Drejtor i Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Shqipëri

Kesjana Halili | Drejtoreshë e Përgjithshme e Borxhit Publik dhe Bashkërendimin të Ndhmës së Huaj, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Shqipëri

Artur Hambardzumyan | Shef i Sektorit të Strategjisë dhe Menaxhimit të Risqeve, Drejtoria Menaxhimit të Borxhit Publik, Ministria e Financave, Armeni

Zhantai Tentimishev | Shef i Sektorit të Menaxhimit të Borxhit Publik, Ministria e Financave, Kirgizstan

Diskutues: **Evis Rucaj** | Ekonomiste e Lartë, Sektori i Statistikave të Ekonomisë dhe Borxhit, DEC, Banka Botërore

Drejtues: **Arman Vatyán** | Kryespecialist për menaxhimin financiar, Banka Botërore

09:45

Si mund ta rritin transparencën Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik

Ian Carruthers | Kryetar i BSNKSP-së

10:00

Raportimi financiar për transparencën e borxhit dhe të investimeve si pjesë e një programi më të gjerë të qeverisjes

Roby Senderowitsch | Menaxher i Praktikës Globale perëndimore për Qeverisjen, EAQ, BB

10:10

Hapat në vijim dhe fjala e mbylljes

Daniel Boyce | Menaxher, Praktika Globale Lindore për Qeverisjen, EAQ, BB

10:20

Fundi i seminarit

JETËSHKRIMET E FOLËSVE DHE DREJTUESVE TË SEANCAVE

(sipas rendit të marrjes së fjalës)



DANIEL BOYCE

Menaxher i Praktikës së Qeverisjes, Banka Botërore

Daniel Boyce është Menaxher Praktike për Llogaridhënien dhe Raportimin Financiar në Praktikën Globale për Qeverisjen të Bankës Botërore. Aktualisht mbulon Amerikën Latine dhe Karaibet, si edhe Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore. Është kontabilist publik i certifikuar (CPA) dhe mban titullin doktor në shkenca politike nga Universiteti i Kalifornisë, Los Anxhelos (UCLA). Zoti Boyce është përgjegjës për mbikëqyrjen e cilësisë së punës në drejtimin financiar operativ të Bankës Botërore dhe aktiviteteve për rritjen e kapaciteteve të zhvilluara nga personeli i drejtimit financiar në të dy rajonet përkatëse të BB-së, përfshirë edhe udhëheqjen e nismave të lidhura me kontabilitetin, raportimin financiar dhe auditimin.



DMITRI GOURFINKEL

Specialist i lartë për drejtimin financiar, Drejtues Ekipi për KPRF PULSAR, Banka Botërore

Dmitri Gourfinkel është specialist i lartë për drejtimin financiar pranë Praktikës Globale të Qeverisjes në Bankën Botërore dhe ka 14 vjet përvojë profesionale në menaxhimin e financave publike dhe përputhshmërinë me detyrimet e besnikërisë në një sërë vendesh. Përpara se të fillojë punë në Bankën Botërore në vitin 2007, ka mbajtur disa poste në nivel të qeverisjes qendrore dhe nënqendrore në Meksikë, si Këshilltar i Ministrit të Financave, Kryekëshilltar i Zëvendësdrejtorit të Thesarit të Federatës dhe Kryekëshilltar i Kryetarit të Kontrollit të Shtetit për Qytetin e Meksikos. Dmitri është kontabilist publik i certifikuar nga Instituti Meksikan i Kontabilistëve të Autorizuar dhe ka kryer studimet e nivelit Master për administrim publik pranë fakultetit “Maxwell School of Citizenship dhe Public Affairs” të Universitetit të Sirakuzës. Dmitri është drejtues i ekipit të projektit për nënaktivitetin e kuadrit të raportimit financiar pranë programit PULSAR.



DOERTE DOEMELAND

MP, Sektori për Makroekonominë dhe Borxhin MTI, Banka Botërore

Doerte Doemeland është menaxhere praktike për analizën makro dhe të borxhit në Praktikën Globale për Makroekonominë, Tregtinë dhe Investimet (MTI) pranë Bankës Botërore. Realizon detyra teknike, analitike dhe operative në vendet me nivel të ulët dhe të mesëm të ardhurash në EAQ, ALK dhe Afrikën Sub-Sahariane, përfshirë edhe rolin e Krye-ekonomistit për Shtetet Anëtare të BE-së dhe për Vendet e Andeve. Ka punuar dy vjet edhe pranë Departamentit Kërkimore të Bankës Botërore, së bashku me Nënpresidentin e Lartë dhe Krye-Ekonomistin. Ka qenë menaxhere e parë e programit për Instrumentin e Menaxhimit të Borxhit (IMB) të Bankës Botërore, ku ka pasur detyrën e ngritjes së IMB-së dhe krijimit të programit të punës. Doerte ka botuar disa libra, kapitujsh dhe artikujsh në buletine shkencore, për çështje që kanë të bëjnë me politikën buxhetore, borxhin dhe rritjen. Ka PhD në shkencat ekonomike nga Universiteti “Pompeu Fabra” (Spanjë).



SVETLANA KLIMENKO

Krye-Specialiste për Drejtimin Financiar, Banka Botërore

Svetlana Klimenko është krye-specialiste për drejtimin financiar pranë Bankës Botërore. Në kuadër të punës së saj, ajo kontribuon për bashkërendimin e angazhimit të shoqërive tregtare me investitorët institucionalë dhe udhëheq dialogun teknik me organet botërore të vendosjes së standardeve, me fokus në fusha të tilla si raportimi financiar dhe raportimi i integruar. Svetlana është anëtare e Komitetit Këshillimor Shumëpalësh të nivelit të lartë që mbikëqyr Raportimin e Platformës së Veprimit mbi nismën e OZHQ-ve të udhëhequr nga Kompakti Global i OKB-së dhe Nisma Globale e Raportimit. Ajo përfaqëson Bankën Botërore në Komitetin e Mbikëqyrjes të Institutit Ndërkombëtar të Auditimit të Brendshëm. Përpara punës në Bankën Botërore, ka qenë menaxhere në Deloitte. Ka diplomë të nivelit Master në shkencë ekonomike dhe inxhinieri dhe është Certified Public Accountant (SHBA) dhe Fellow Certified Chartered Accountant (Britani e Madhe).



DRITAN FINO

Drejtor i Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Shqipëri

Zoti Dritan Fino, me gradën doktor, është Drejtor i Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontabilitetit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në Shqipëri. Ka filluar punë pranë kësaj ministrie në muajin nëntor 2013, si këshilltar i Kabinetit të Ministrit. Gjatë kësaj periudhe, përgjegjësitë e tij kryesore lidhen me çështje të auditimit, kontabilitetit dhe drejtimit dhe kontrollit financiar. Zoti Fino jep prej vitit 2007 leksione në institucione të ndryshme në Shqipëri dhe jashtë saj. Në kuadër të angazhimit akademik ai ka publikuar edhe disa kumtesa. Mësimdhënia dhe puna kërkimore e tij kanë lidhje me fushat e kontabilitetit financiar dhe kontabilitetit të drejtimit, standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të auditimit, financat publike etj. Përvoja të tjera profesionale përfshijnë angazhime si kryetar i Bordit të Mbikëqyrjes Publike të Audituesve Ligjorë, kryetar i Komisionit të Kualifikimit dhe Certifikimit të Audituesve të Brendshëm Publikë, anëtar i Autoritetit të Regjistrimit pranë Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë, anëtar i Komitetit të Rekrutimit të Nëpunësve Civilë etj. Në vitin 2002 është diplomuar për financë dhe kontabilitet në Universitetin e Tiranës. Prej vitit 2004 ndoqi studimet pasuniversitare në programin prestigjioz Monbukagakusho, ku fitoi diplomën master në vitin 2007 dhe titullin doktor në financë dhe kontabilitet në vitin 2010.



KESJANA HALILI

Drejtoreshë e Përgjithshme e Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Shqipëri

Zonja Kesjana Halili është aktualisht Drejtoreshë e Përgjithshme e Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të Shqipërisë. Është përgjegjëse për menaxhimin e borxhit publik, me objektiv minimizimin e risqeve dhe të kostove efektive totale të financimit. Zonja Halili ka mbajtur për gjashtë vjet postin e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Harmonizimit të Kontrollit Financiar të Brendshëm Publik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të Shqipërisë. Në këtë post ka qenë përgjegjëse për harmonizimin e kuadrit rregullator, monitorimin dhe raportimin e menaxhimit financiar, kontrollin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm në sektorin publik. Zonja Halili ka 13 vjet përvojë pune pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Zonja Halili jep mësim në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës prej vitit 2007. Në kuadër të angazhimit të saj akademik, ka botuar edhe disa kumtesa dhe ka marrë pjesë në një sërë konferencash dhe seminaresh. Fushat e mësimdhënies dhe hulumtimit kanë të bëjnë me investimet financiare,

financat publike, kontrollin e brendshëm, auditimin, kontabilitetin etj. Përvoja të tjera profesionale përfshijnë angazhimet si anëtare e Këshillit Kombëtar të Kontabilitet prej vitit 2014, anëtare e Autoritetit të Regjistrimit pranë Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë prej vitit 2018 etj. Zonja Halili ka kryer studimet e ciklit të parë dhe të dytë, përkatësisht në 2004 dhe 2006, në bankë dhe financë pranë Universitetit të Mesdheut Lindor të Republikës Turke të Qipros së Veriut. Në vitin 2016 ka fituar titullin doktor në shkencë nga Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Tiranës, me fokus në punën kërkimore mbi sistemet e kontrollit të brendshëm të sektorit publik dhe ndikimin që ka auditimi i brendshëm në efektivitetin e këtyre sistemeve.



ARTUR HAMBARDZUMYAN

Shef i Sektorit të Strategjisë dhe Menaxhimit të Risqeve, Drejtoria Menaxhimit të Borxhit Publik, Ministria e Financave, Armeni

Artur Hambardzumyan aktualisht punon si Shef i Sektorit të Strategjisë dhe Menaxhimit të Risqeve në DMB pranë Ministrisë së Financave të Armenisë. Ka studiuar shkencë ekonomike në Universitetin Ekonomik Shtetëror të Jerevanit në Armeni dhe marrëdhënie ndërkombëtare në Fakultetin e së Drejtës dhe Diplomacisë “Fletcher” të Universitetit TUFTS në SHBA. Ka më shumë se 20 vjet përvojë në nisma të menaxhimit financiar dhe reforma të menaxhimit të borxhit, përfshirë zhvillimin e tregut të brendshëm të borxhit, krijimin e një sistemi tregtimi parësor, konceptimin dhe hartimin e strategjisë afatmesme për menaxhimin e borxhit shtetëror, zhvillimin e tregut me pakicë të letrave me vlerë të qeverisë, shpërndarjen e Eurobondit në tregun ndërkombëtar të kapitalit, menaxhimin e risqeve të portofolit të borxhit shtetëror, përpilimin dhe publikimin e raporteve vjetore dhe gjashtëmujore për borxhin publik. Ka më shumë se 10 vjet përvojë bashkëpunimi me IFN-të, si edhe përvojë në menaxhimin dhe parashikimin e likuiditetit. Ka ofruar konsultime si ekspert i lartë jo kryesor në kuadër të asistencës teknike të BE-së për përmirësimin e politikave për financat publike dhe ka bashkëpunuar me zyrat e menaxhimit të borxhit të vendeve të ndryshme në kuadër të shkëmbimit të përvojës. Ka përvojë në mësimdhënie si lektor i jashtëm në universitete të Armenisë.



ZHANTAI TENTIMISHEV

Shef i Sektorit të Menaxhimit të Borxhit Publik, Ministria e Financave, Kirgizstan

Në vitin 2013, Zhantai Tentimishev është diplomuar nga Universiteti Sllav Kirgizo-Rus me diplomë në metodat matematikore të shkencave ekonomike. Në vitin 2013, u bë kryespecialist në Drejtorinë e Politikave

Buxhetore (DPB) të Ministrisë së Financave të Republikës së Kirgizstanit. Gjatë 5 viteve të ardhshme (2013-2017) zoti Tentimishev ka punuar në të gjithë sektorët e DPB-së, si buxheti programor, planifikimi buxhetor dhe parashikimi buxhetor afatmesëm. Gjatë 5 viteve mbikëqyri procesin e përgatitjes dhe hartimit të buxhetit të shtetit. Zoti Tentimishev u bë një prej zhvilluesve të bazës së të dhënave për hartimin dhe planifikimin e buxhetit të shtetit. Gjatë punës së tij në DPB, është bërë anëtar i përhershëm dhe organizator i Këshillit të Bashkërendimit Ndërdikasterial midis Bankës Kombëtare të RK-së dhe Ministrisë së Financave të RK-së, anëtar i përhershëm i Grupi Ndërdikasterial për Programimin Financiar, si edhe anëtar i Grupit Ndërdikasterial të Punës për Parashikimin Makroekonomik. Ka marrë pjesë në formime dhe seminare me mbështetjen e Fondit Monetar Ndërkombëtar në Gjeorgji dhe Austri, përkatësisht për programimin financiar dhe për rregullat buxhetore.



EVIS RUCAJ

Ekonomiste e Lartë, Sektori i Statistikave të Ekonomisë dhe Borxhit, DEC, Banka Botërore

Zonja Evis Rucaj është ekonomiste e lartë/statisticiene pranë Bankës Botërore. Ka mbi 20 vjet përvojë në statistikat e sektorit të jashtëm në lidhje me politikat. Udhëheq ekipin e statistikave të borxhit pranë Grupit të të Dhënave për Zhvillimin. Evisi mbikëqyr përpilimin dhe shpërndarjen e statistikave mbi borxhin e jashtëm në bazën e të dhënave të Sistemit të Raportimit të Debitorëve (DRS) të Bankës Botërore. Përpara Bankës Botërore, ka punuar si Zëvendësdyretore e Departamentit të Statistikave pranë Bankës së Shqipërisë.



ARMAN VATYAN

Menaxher i Programit PULSAR, Kryespecialist për drejtimin financiar, Banka Botërore

Arman Vatyan, kontabilist i autorizuar në Britaninë e Madhe dhe Kanada, Drejtues Programi PULSAR është pikë qendrore kontakti për Praktikën Globale të Qeverisjes në Bankën Botërore, i cili mbikëqyr zbatimin e veprimtarive të BB-së në fushën e Qeverisjes në Azinë Qendrore përfshirë në fushën e menaxhimit financiar. Ai ka më se 20 vjet përvojë në drejtimin e nismave dhe reformave të rëndësishme të menaxhimit financiar, përfshirë në kontabilitetin dhe raportimin financiar në sektorin publik dhe atë privat, auditimin e brendshëm dhe të jashtëm publik, sistemin e informacionit të menaxhimit financiar (FMIS) dhe kontrollin e brendshëm publik në 24 vende në Evropë dhe Azinë Qendrore, Amerikën Latine dhe Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut. Ai drejton edhe Komunitetin e Praktikës për Auditimin e Brendshëm të PEMPAL në 23 vende (prej vitit 2008) dhe programe të tjera të suksesshme të

MFP. Përpara se t'i bashkohej Bankës Botërore, ka punuar në KPMG për t'u ofruar këshilla për drejtimin e brendshëm, planifikimin strategjik, MIS, ristrukturimin, marrjet në pronësi dhe privatizimin qeverive dhe njësisve ekonomike të mëdha me interes publik. Ka rreth 20 vjet përvojë në mësimdhënie në kurset e ACCA dhe si lektor i jashtëm në universitete dhe programe master.



IAN CARRUTHERS

Kryetar i BSNKSP-së

Ian Carruthers është emëruar Kryetar i Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (BSNKSP) më 2016, ndërsa anëtar i këtij Bordi ka qenë prej vitit 2010, ku ka udhëhequr punën e BSNKSP-së për qëndrueshmërinë financiare afatgjatë dhe harmonizimin midis Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) dhe Statistikave të Financave Shtetërore (GFS). Më 1999 zoti Carruthers ka kaluar me punë nga PricewaterhouseCoopers në Thesarin e Britanisë së Madhe ku ka luajtur një rol kyç në kalimin e Qeverisë së Britanisë së Madhe nga hartimi dhe raportimi i buxhetit me baza monetare në atë me të drejta dhe detyrime të konstatuara, në veçanti duke udhëhequr programin e Llogarive të Gjithë Qeverisjes (WGA). Është anëtarësuar në Institutin e Autorizuar të Financave & Kontabilitetit Publik (CIPFA) më 2006. Si kryetar me kohë të pjesshme i Standardeve në CIPFA, roli i zotit Carruthers përfshinë të gjitha këto aspekte të aktiviteteve të CIPFA-s.



ROBY SENDEROWITSCH

Menaxher i Praktikës Globale perëndimore për Qeverisjen, EAQ, BB

Roby Senderowitsch është aktualisht Menaxher Praktikë Globale për Qeverisjen në EAQ Perëndim. Më parë ka mbajtur poste ndryshme, ndër të tjera Menaxher për Udhëheqjen, Mësimin dhe Novacionin; Menaxher i Partneritetit Global për Llogaridhënien Sociale (GPSA); dhe Drejtor i Zyrës Lokale të Bankës Botërore në Republikën Dominikane. Puna e tij në Bankën Botërore ka përfshirë një fokus të fuqishëm të analiza e ekonomisë politike, ngritja e koalicioneve për ndryshim, lufta kundër korrupsionit dhe drejtimi i bazuar në performancë i institucioneve publike. Ka qenë lektor për drejtimin e burimeve njerëzore në organizatat jofitimprurëse, si edhe drejtor i programeve edukative dhe të zhvillimit të komunitetit dhe drejtimin të burimeve njerëzore në sektorin privat. Në botimet e Roby-t përfshihen "Qeverisja demokratike në Meksikë: përtej kapjes së shtetit dhe polarizimit shoqëror" (me Yasuhiko Matsuda), "Buxheti i mbështetur në informacionin për performancën dhe besimi të qeveria"

(me Nick Manning dhe të tjerë) dhe “Nga kriza financiare ndërkombëtare drejt rritjes gjithëpërfshirëse në Republikën Dominikane.”

PROGRAMI PULSAR

MENAXHOHET NGA:




CFRR 
**Centre for Financial
Reporting Reform**



BASHKËFINANCOHET NGA:

 **Federal Ministry
Republic of Austria
Finance**

 **Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra**

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO